



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT KLINË

Nr. 11-32001/119

Datë, 28.08.2019

Drejtori i DKA-së: **Arben Limanaj**

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsim Parauniversitar 04/L-32, Udhëzimin Administrativ 07/2017 (MPMS), Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë shpall:

K O N K U R S

Nr.	Pozita	Shkolla	Orë mësimore	Fillon punën
1.	1 punëtor ndihmës	SHFMU "Tre Deshmorët "Jashanicë	40 orë pune	Pas konkursit

KUSHTET:

- Për këto vende të punës kërkohet që të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Klinë.

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi

Punëtori ndihmës kujdeset për mirëmbajtjen, pastërtinë dhe rregullimin e të gjitha hapësirave shkollore të përcaktuara nga drejtori.

Të tregojë respekt, sjelle kolegiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon; I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Aplikacioni merret në DKA, duke ia bashkëngjitur dokumentet tjera si më poshtë:

- Diploma (certifikata) e fotokopjuar .
- Certifikata e lindjes.
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Dokumenti i përvojës së punës (nëse ka).
- Vërtetimi se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale.

UDHËZIM PËR APLIKIM:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga data e publikimit dhe mbyllet më datën **12.09.2019**. Për datën dhe orën e testit dhe intervistimit ju njoftojmë menjëherë pas mbylljes së konkursit, në webfaqen e komunes dhe tabelen e shpalljeve. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me dokumentet e cekura më lart.

Vërejtje : Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen si dhe nuk kthehen pas konkurimit.